

20101242447

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT**  
**PËR SIGURIM PENSIONAL VULLNETAR ME FINANCIM KAPITAL**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 7/2008) në nenin 4 paragrafi (1) pika 12 ndryshohet si vijon:

""Person i lidhur" lidhur me person të caktuar juridik ose fizik është:

a) aksionari individual ose grup aksionarësh të cilët posedojnë së paku 10% nga aksionet me të drejtë vote ose posedojnë përqindje më të vogël dhe kanë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendosjen në atë person juridik;

b) çdo person tjetër juridik në të cilin personi i parë juridik, në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë, posedon së paku 10% nga aksionet me të drejtë vote ose posedon përqindje më të vogël dhe ka kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendosjen në atë personi juridik;

v) çdo person tjetër juridik në të cilin një aksionar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, posedon më shumë se 20% nga aksionet me të drejtë vote dhe në periudhë të njëjta kohore i njëjti aksionar posedon, në mënyrë të tërthortë ose drejtpërdrejtë, më shumë se 20% nga aksionet me të drejtë vote në personin e parë juridik;

g) personi fizik ose personi juridik të cilët kanë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose janë të kontrolluar nga ose janë nën kontroll të përbashkët të personit juridik;

d) anëtari i bordit drejtues, bordit mbikëqyrës ose anëtari i organit tjetër të menaxhimit ose mbikëqyrjes të personit juridik dhe

gj) në lidhje me personat e theksuar në këtë pikë, persona të cilët janë: farefis nëpërmjet martesës ose adoptimit; fëmijë dhe prindër, vëllezër dhe motra, vëllezër nga njëri prind dhe motra nga njëri prind, gjyshe, gjyshër dhe nipa; në mënyrë tjetër janë në lidhje gjaku deri në shkallë të dytë; persona të cilët janë në lidhje: prind kujdestar dhe fëmijë, njerë ose njerë dhe i birësuar dhe e birësuar dhe nuse, dhëndër dhe prindër të bashkëshortëve;".

Pas pikës 20 shtohen tri pika të reja 21, 22 dhe 23 si vijojnë:

21. "Reputacion i mirë" është ndershmëria, kompetenca, zotësia dhe posedimi i veçorive të cilat sigurojnë se personi, me mënyrën e punës së tij, nuk do të ndikojë në drejtim të kërcënimit të stabilitetit dhe sigurisë së shoqërisë pensionale dhe fondit me të cilin menaxhon, si dhe cenimit të autoritetit dhe besimit;

22. "Anëtar i pavarur i bordit mbikëqyrës" është personi fizik i cili:

a) në pesë vitet e fundit nuk ka pasur interes material ose marrëdhënie afariste me shoqërinë si partner afarist, si i punësuar ose anëtar i bordit drejtues ose bordit mbikëqyrës të shoqërisë;

b) nuk është person i lidhur i shoqërisë, i punësuar te personi i lidhur i shoqërisë ose përfaqëson person të lidhur të shoqërisë;

v) nuk është person i lidhur fizik me anëtar të bordit drejtues ose bordit mbikëqyrës të shoqërisë dhe

g) nuk ka punuar dhe nuk punon në shoqëri për revizion e cila në tre vitet e fundit ka kryer revizion të jashtëm të punës së shoqërisë.

23. "Material për marketing" është materiali i tërësishëm për reklamim, promovim ose informatë, para lëshimit, shpërndarjes ose shpalljes së tij në mjetet e informimit publik, i cili ka të bëjë me fondin pensional vullnetar ose me shoqërinë e cila menaxhon me atë fond."

Neni 2

Në nenin 10 paragrafi (2) në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe çdo ndryshim i tij".

Neni 3

Në nenin 13 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Shoqëria punon në pajtim me rregullat për menaxhim të mirë korporativ.

(3) Agjencia i përcakton rregullat për menaxhim të mirë korporativ të shoqërive."

Neni 4

Në nenin 18 pas paragrafit (1) fjalët: "Kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "Kryegjësja themelore".

Në paragrafin (4) fjala: "kapitali" zëvendësohet me fjalët: "kryegjësja themelore".

Neni 5

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"(1) Kryegjësja themelore e shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare është së paku 500.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(2) Kur mjetet e fondit pensional vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria për menaxhim me fonde pensionale vullnetare do të tejkalojnë 50.000.000 euro dhe në çdo rast të ardhshëm, kur mjetet e fondit pensional vullnetar do të zmadhohen për 50.000.000 euro plotësuese, ajo shoqëri është e obliguar që në afat prej 45 ditëve të punës ta zmadhojë kryegjësën e saj së paku deri në shumën në vijim:

Mjetet e fondit pensional vullnetar	Kryegjësja e shoqërisë
Prej 50.000.001 euro deri në 100.000.000 euro	1.000.000 euro
Prej 150.000.001 euro deri në 200.000.000 euro	1.500.000 euro
Prej 250.000.001 euro deri në 300.000.000 euro	2.000.000 euro
Prej 350.000.001 euro deri në 400.000.000 euro	2.500.000 euro
Prej 450.000.001 euro deri në 500.000.000 euro	3.000.000 euro
Prej 550.000.001 euro deri në 600.000.000 euro	3.500.000 euro
Prej 650.000.001 euro deri në 700.000.000 euro	4.000.000 euro
Prej 750.000.001 euro deri në 800.000.000 euro	4.500.000 euro
Mbi 800.000.001 euro	5.000.000 euro

(3) Eurot llogariten në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(4) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale vullnetare është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kryegjësës por jo më pak se gjysma nga shuma e kryegjësës themelore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse vjen deri te zmadhimi i kryegjësës së shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, ajo shoqëri është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e zmadhuar të kryegjësës.

(6) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale vullnetare është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë mjete personale në shumë jo më të vogël se gjysma nga shuma e kryegjësës themelore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Nëse vjen deri te zmadhimi i kryegjësës së shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, ajo shoqëri është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë mjete personale në shumë jo më të vogël se gjysma nga shuma e kryegjësës nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Mjetet personale nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni të shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare përbëhen nga kryegjëja themelore, rezervat dhe zërat tjera, të llogaritura sipas metodologjisë të cilën e përcakton Agjencia.

(9) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale vullnetare është e obliguar që në çdo kohë të mbajë shumë të mjeteve likuide si përqindje nga kryegjëja themelore nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht kryegjëja nga paragrafi (2) i këtij neni.

(10) Përqindjen minimale të mjeteve likuide nga paragrafi (9) i këtij neni e përcakton Agjencia."

#### Neni 6

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“(1) Kryegjëja themelore e shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare është së paku 1.800.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(2) Kur mjetet e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare me të cilat menaxhon shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare do të tejkalojnë 100.000.000 euro dhe në çdo rast të ardhshëm kur mjetet e fondeve pensionale do të zmadhohen për 100.000.000 euro plotësuese, ajo shoqëri është e obliguar që në afat prej 45 ditëve të punës ta zmadhojë kryegjënë e vet së paku deri në shumën në vijim:

Mjete të fondit pensional të obligueshëm ose vullnetar në mënyrë kumulative	Kryegjëja e shoqërisë
Prej 100.000.001 euro deri në 200.000.000 euro	2.800.000 euro
Prej 200.000.001 euro deri në 300.000.000 euro	3.800.000 euro
Prej 300.000.001 euro deri në 400.000.000 euro	4.800.000 euro
Prej 400.000.001 euro deri në 500.000.000 euro	5.800.000 euro
Prej 500.000.001 euro deri në 600.000.000 euro	6.800.000 euro
Prej 600.000.001 euro deri në 700.000.000 euro	7.800.000 euro
Prej 700.000.001 euro deri në 800.000.000 euro	8.800.000 euro
Prej 800.000.001 euro deri në 900.000.000 euro	9.800.000 euro
Mbi 900.000.001 euro	10.000.000 euro

(3) Eurot llogariten në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(4) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kryegjësë por jo më pak se gjysma nga shuma e kryegjësë themelore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse vjen deri te zmadhimi i kryegjësë së shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, ajo shoqëri është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e zmadhuar të kryegjësë.

(6) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare është e obliguar që në çdo kohë të mbajë mjete personale në shumë jo më të vogël se gjysma nga shuma e kryegjësë themelore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Nëse vjen deri te zmadhimi i kryegjësë së shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare në pajtim me paragrafin (2) i këtij neni, ajo shoqëri është e obliguar që në çdo kohë të mbajë mjete personale në shumë jo më të vogël se gjysma nga shuma e kryegjësë nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Mjetet personale nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni të shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare përbëhen nga kryegjëja themelore, rezervat dhe zëra tjera, të llogaritura sipas metodologjisë të cilën e përcakton Agjencia.

(9) Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare është e obliguar që në çdo kohë të mbajë shumë të mjeteve likuide si përqindje nga kryegjëja themelore nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht kryegjëja nga paragrafi (2) i këtij neni.

(10) Përqindjen minimale të mjeteve likuide nga paragrafi (9) i këtij neni e përcakton Agjencia."

#### Neni 7

Në nenet 21 dhe 22 fjalët: "Kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "Kryegjëja themelore".

#### Neni 8

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqëria është e obliguar që menjëherë ta njoftojë Agjencinë për çdo zvogëlim të kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide nën shumat e përcaktuara me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

(2) Agjencia mund ta shfuqizojë lejen për menaxhim me fond pensional vullnetar të shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare, nëse pas zvogëlimit të kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide, nën shumën e kërkuar shoqëria nuk do ta bëjë zmadhimin e kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide deri në shumën e kërkuar, në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 12 muaj.

(3) Agjencia mund t'ia shfuqizojë lejen për menaxhim me fond pensional vullnetar dhe lejen për menaxhim me fond pensional të obligueshëm shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nëse pas zvogëlimit të kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide nën shumën e kërkuar shoqëria nuk do ta bëjë zmadhimin e kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide deri në shumën e kërkuar, në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 12 muaj."

#### Neni 9

Në nenin 24 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Themeluesit të cilët posedojnë 51% nga kryegjëja themelore e shoqërisë janë bankat, shoqëritë për sigurim, shoqëritë për menaxhim me fonde investuese, shoqëritë e huaja për menaxhim me fonde pensionale dhe institucione tjera financiare, si dhe persona tjerë juridikë të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, posedojnë më shumë se 50% nga aksionet me të drejtë në menaxhim të institucioneve financiare. Nëse nuk ka një themelues ose themelues të cilët posedojnë 51% nga kryegjëja themelore e shoqërisë, atëherë të gjithë themeluesit e plotësojnë këtë kusht."

#### Neni 10

Në nenin 25 paragrafi (1) fjalët: "kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "kryegjëja themelore".

Në pikën a) fjalët: "kryegjëja themelore" zëvendësohen me fjalët: "kryegjëja".

Në paragrafët (2) dhe (3) fjalët: "kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "kryegjëja themelore".

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"(4) Nëse nuk ka një themelues ose themelues të cilët posedojnë 51% nga kryegjëja themelore të shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare, atëherë të gjithë themeluesit i plotësojnë kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni."

#### Neni 11

Në nenin 26 paragrafi (1) pika a) fjala: “kapital” zëvendësohet me fjalën: “kryegjë”.

#### Neni 12

Në nenin 27 paragrafi (4) fjalët: "kapitali aksionar" zëvendësohen me fjalët: “kryegjëja themelore”.

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5) si vijon:

“(5) Nëse ekzistojnë vetëm dy shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, njëra shoqëri nuk guxon të blejë aksione nga shoqëria tjetër për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe ato nuk guxojnë të bashkohen, bashkëngjiten, ndahen ose në ndonjë mënyrë tjetër të riorganizohen.”

#### Neni 13

Neni 28 ndryshohet si vijon:

“(1) Bordi drejtues i shoqërisë është i përbërë prej së paku dy anëtarëve.

(2) Bordi mbikëqyrës i shoqërisë është i përbërë prej së paku katër anëtarëve.

(3) Nëse zvogëlohet numri i anëtarëve në bordin drejtues nën atë të paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, bordi mbikëqyrës është i obliguar që nga radhët e tij të emërojë ushtrues detyre anëtar i bordi drejtues. Anëtari i bordi drejtues i cili është i emëruar për ushtrues detyre në periudhën e ushtrimit të kësaj detyre, nuk guxon të marrë pjesë në marrjen e vendimeve që janë në kompetencë të bordit drejtues. Ushtruesi i detyrës është lëndë e regjistrimit në Regjistrin qendror.

(4) Për anëtar të bordit drejtues dhe bordit mbikëqyrës mund të emërohet personi i cili, krahas kushteve të parapara në Ligjin për shoqëri tregtare, i plotëson edhe kushtet në vijim:

a) ka arsimim të lartë;

b) ka përvojë pune prej së paku pesë vitesh në sferën e drejtësisë, veprimtarisë bankare, kontabilitetit, sigurimit, menaxhim me mjete dhe investim, menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare ose shërbime financiare prej të cilëve tre vite përvojë pune në pozicion udhëheqës;

v) të mos ketë sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim profesioni, veprimtarie dhe detyre në sferat e theksuara në pikën b) të këtij paragrafi;

g) të mos vuajë dënim për veprë penale nga sfera e financimit dhe veprimtarisë bankare dhe shkaktimit të falimentimit të personit juridik dhe

d) posedon reputacion të mirë me çfarë do të mundësohet siguri dhe punë e qëndrueshme e shoqërisë dhe fondit pensional.

(5) Agjencia me detyrë zyrtare siguron informata nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë për paragrafin (4) pikat v) dhe g) nga ky nen, ndërsa i huaji vetë siguron informata të tilla nga institucionet kompetente në vendin e huaj.

(6) Krahas kushteve nga paragrafi (4) i këtij neni, anëtari i bordi drejtues i shoqërisë plotësisht duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

a) t'i njohë rregullat nga sfera e sigurimit pensional me financim kapital dhe

b) të dorëzojë program për punë të shoqërisë dhe fondit pensional nga fushëveprimi i tij i punës.

(7) Së paku një nga anëtarët e bordit drejtues duhet të ketë të dhënë provim për këshilltar investues ose provim tjetër përkatës nga institucioni kompetent jashtë vendit.

(8) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtues përcaktohet se cilët anëtarë zgjidhen si anëtarë të pavarur të bordit mbikëqyrës.

(9) Anëtarët e Bordit drejtues së shoqërisë duhet të punësohen në shoqërinë pas marrjes së lejes nga Agjencia.

(10) Agjencia më afërsisht e rregullon mënyrën dhe procedurën për zgjedhje të anëtarit të bordit drejtues ose bordit mbikëqyrës të shoqërisë pensionale.

(11) Agjencia e heq përkatësisht shfuqizon lejen për anëtar të bordit drejtues ose mbikëqyrës kur do të përcaktojë se:

a) vendimi për dhënien e lejes është miratuar në bazë të të dhënave të pavërteta dhe të pasakta;

b) në periudhën pas dhënies së lejes merr dëshmi të dokumentuar se anëtari mëturje nuk i plotëson kushtet e këtij neni;

v) anëtari ka bërë shkelje të rregullave për menaxhim të mirë korporativ, nuk punon në pajtim me program të parashtruar për punë, nuk e zbaton politikën afariste të shoqërisë dhe fondit pensional ose në mënyrë tjetër i kërcënon interesat e anëtarëve të fondit pensional dhe

g) anëtari i bordit drejtues nuk është i punësuar në shoqëri.

#### Neni 14

Në nenin 32 paragrafi (1) pika v) fjalët: “kapitali personal” zëvendësohen me fjalën: “kryegjēja”.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Shoqëria nuk mund të posedojë më shumë se 10% nga kryegjēja themelore e subjekteve nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni.”

#### Neni 15

Neni 34 ndryshohet si vijon:

“(1) Shoqëria është e obliguar që të ketë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm e cila për punën e saj përgjigjet para bordit drejtues të shoqërisë.

(2) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni kryen kontroll të vazhdueshëm dhe të plotë të ligjshmërisë dhe azhurnitetit të punës së shoqërisë, veçanërisht në menaxhimin me mjetet e fondit pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar nëpërmjet, por duke mos u kufizuar në:

a) vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm;

b) vlerësimin e vendosjes së sistemit informativ;

v) vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së raporteve financiare të shoqërisë dhe fondit pensional të obligueshëm edhe/ose vullnetar;

g) kontrollin e saktësisë, besueshmërisë dhe saktësisë në kohë në njoftimin në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore nga sfera përkatëse;

d) përcjelljen e respektimit të rregullave, politikave dhe procedurave nga sfera e punës së shoqërisë, duke i përfshirë edhe politikat për menaxhim me risk dhe kodi etik i shoqërisë;

gj) vlerësimin e sistemeve për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit;

e) vlerësimin e shërbimeve të cilat shoqëria i merr nga bashkëpunëtor të jashtëm; dhe

zh) vlerësimin e efikasitetit të përgjithshëm të punës së shoqërisë.

(3) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni përpilon plan vjetor për punë për vitin e ardhshëm në të cilin obligueshëm theksohet lënda e revizionit me përshkrimin e përmbajtjes së revizionit të planifikuar në sfera të veçanta dhe renditjen e kontrolleve gjatë vitit me kohëzgjatje të planifikuar për zbatimin e kontrolleve. Bordi drejtues i shoqërisë e lejon planin vjetor për punën dhe e dorëzon deri te Agjencia në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së tij.

(4) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni përpilon raport për punën e tij për vitin paraprak dhe e dorëzon në miratim të bordit mbikëqyrës të shoqërisë dhe njëkohësisht e dorëzon deri te Agjencia, më së voni deri më 31 mars.

(5) Bordi mbikëqyrës i shoqërisë raportin e miratuar nga paragrafi (4) i këtij neni e dorëzon te Kuvendi i aksionarëve të shoqërisë dhe njëkohësisht e dorëzon deri te Agjencia.

(6) Personi i punësuar në njësinë organizative nga paragrafi (1) i këtij neni kryen punë vetëm për revizionin e brendshëm.

#### Neni 16

Në nenin 38 në paragrafi (1) në fjalinë e dytë pas fjalës: “fond” shtohen fjalët: “edhe kërkesa për regjistrim në fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

#### Neni 17

Në nenin 39 paragrafi (1) pika gj), fjalët: "aktet themeluese dhe statutet" zëvendësohen me fjalët: "statutet ose aktet tjera themeluese".

Në pikën zh) fjalët: “kapital themelues” zëvendësohen me fjalët: “kryegjë themelore”.

Në pikën z) pas fjalës: “përvojë” shtohen fjalët: “me rekomandime”.

Pika k) ndryshohet si vijon:

“prospekt informativ për fondin pensional vullnetar, program për strategji investuese të fondit pensional vullnetar dhe program për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit dhe”.

Në paragrafin (2) fjalët: "Në afat prej 30 ditësh nga dita e" zëvendësohen me fjalën: “Pas”.

Në paragrafin (3) shtohet pikë e re a) si vijon:

"a) të kërkojë informatë nga Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit për përfshirjen e themeluesve në raste të larjes së parave ose financim të terrorizmit”.

Pikat a) dhe b) bëhen pika b) dhe v).

#### Neni 18

Në nenin 43 paragrafi (1) fjalët: “kopje të verifikuara nga aktet dhe statuti themelues” zëvendësohen me fjalët: “kopje të verifikuar nga statuti”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

“(3) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fond pensional vullnetar Agjencia e regjistron fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe i cakton numër identifikimi.

(4) Regjistrimi i fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

#### Neni 19

Në nenin 44 paragrafi (1) fjala: “paraprak” shlyhet.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Agjencia e përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni”.

#### Neni 20

Në nenin 45 paragrafi (1) në rendin e dhjetë pas fjalës: “ligj” shtohen fjalët: “edhe të Ligjit për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhura tjera nga vepra penale dhe financimi i terrorizmit”.

Në paragrafin (2) fjalët: “edhe parregullsitë” shlyhen.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

“(6) Pas heqjes së lejes për menaxhim me fondin pensional vullnetar, në shoqërinë e cila ka menaxhuar me atë fond pensional në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për likuidim të shoqërive nga Ligji për shoqëri tregtare ose dispozitat nga Ligji për falimentim.”

#### Neni 21

Në nenin 48 në paragrafin (3) në fjalinë e dytë pas fjalës: “fond” shtohen fjalët: “edhe kërkesa për regjistrimin e fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) si vijojnë:

“(7) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fond pensional vullnetar Agjencia e regjistron fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe i përcakton numër identifikimi.

(8) Regjistrimi në fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare.”

Paragrafët (7) dhe (8) bëhen paragrafë (9) dhe (10).

#### Neni 22

Në nenin 54 paragrafi (1) në fjalinë e dytë pas fjalës: “fond” shtohen fjalët: “edhe kërkesat për regjistrimin e fondit pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

#### Neni 23

Në nenin 55 paragrafi (1) pika gj) ndryshohet si vijon:

“për të gjithë personat të cilët kanë qenë themelues, kopje të verifikuara nga statutet ose akte tjera themelues dhe ekstrakt nga organi kompetent në të cilin janë regjistruar, emra dhe adresa të anëtarë të bordeve drejtues dhe kopje të verifikuara nga tre raportet e fundit financiare të reviduara nga revizori i jashtëm i autorizuar, si dhe çdo dëshmi plotësuese e nevojshme që të tregohet se janë të plotësuara kushtet nga neni 26 të këtij ligji”.

Pika e) ndryshohet si vijon:

“dokumente me të cilat vërtetohet se në datën e parashtrimit të kërkesave, themeluesit të cilët do të mbajnë 51% nga kryegjëja themelore e shoqërisë kanë përvojë të madhe në menaxhim me mjetet”.

Në pikën zh) fjalët: “kapital themelues” zëvendësohen me fjalët: “kryegjë themelore”.

Në pikën z) pas fjalës: “përvojë” shtohen fjalët: “me rekomandime”.

Pika k) ndryshohet si vijon: “prospekte informative për fondet pensionale, programe për strategji investuese të fondeve pensionale dhe program për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit dhe”.

Në paragrafin (2) fjalët: “Në afat prej 30 ditësh nga dita e” zëvendësohen me fjalën: “Pas”.

Në paragrafin (3) shtohet pikë e re a) si vijon:

“a) të kërkojë informatë nga Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit për përfshirjen e themeluesve në raste të larjes së parave ose financimin e terrorizmit”.

Pikat a) dhe b) bëhen pika b) dhe v).

#### Neni 24

Në nenin 59 paragrafi (1) fjalët: “kopje të verifikuara nga aktet themeluese dhe statutit” zëvendësohen me fjalët: “kopje e verifikuar nga statuti”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

“(3) Pas plotfuqishmërisë së lejeve për menaxhim me fond pensional të obligueshëm dhe vullnetar Agjencia i regjistron fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe për çdo fond cakton numër identifikimi.

(4) Regjistrimi në fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

#### Neni 25

Në nenin 60 paragrafi (1) fjala: "paraprak" shlyhet.  
Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:  
"(3) Agjencia e përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni".

#### Neni 26

Në nenin 61 paragrafi (2) pas fjalës: "fonde" shtohet presje dhe fjalët: "si dhe regjistrimi i fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare", ndërsa fjala: "kërkesë" zëvendësohet me fjalën: "kërkesa".

Në paragrafin (3) fjala: "kërkesa" zëvendësohet me fjalët: "kërkesat", ndërsa fjalët: "parashtron të nënshkruar" zëvendësohen me fjalët: "parashtrojnë të nënshkruara".

Në paragrafin (4) fjalët: "Në afat prej 30 ditësh nga dita e" zëvendësohen me fjalën: "Pas".

Në paragrafin (5) shtohet pikë e re a) si vijon:

"a) të kërkojë informatë nga Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit për përfshirjen e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe themeluesit në raste të larjes së parave ose financim të terrorizmit".

Pikat a) dhe b) bëhen pika b) dhe v).

#### Neni 27

Në nenin 62 paragrafi (1) pika a) fjalët: "kapital themelues i paguar i përcaktuar" zëvendësohen me fjalët: "kryegjë e paguar themelore e përcaktuar".

#### Neni 28

Në nenin 65 paragrafi (1) fjalët: "kopje të verifikuara nga aktet themeluese dhe statuti" zëvendësohen me fjalët: "kopje e verifikuar nga statuti".

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

"(3) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fond pensional vullnetar Agjencia e regjistron fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe i cakton numër identifikimi.

(4) Regjistrimi i fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

#### Neni 29

Në nenin 66 paragrafi (1) fjala: "paraprak" shlyhet, ndërsa fjalia e dytë ndryshohet si vijon: "Për ndryshimet e krijuara jashtë nga kontrolli i shoqërisë, ajo është e obliguar që ta njoftojë Agjencinë".

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Agjencia i vlerëson ndryshimet nga paragrafi (1) i këtij neni në pajtim me dispozitat për plotësimin e kushteve nga neni 62 të këtij ligji.

"(3) Agjencia e përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni."

#### Neni 30

Në nenin 67 paragrafi (2) pas fjalës: "fonde" në rendin e katërt vihet presje dhe shtohen fjalët: "si dhe regjistrimi i fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare", fjala: "kërkesë" zëvendësohet me fjalën: "kërkesa", ndërsa fjalët: "dhe kanë rejting të rekomanduar për investim sipas rejting agjencive me renome ndërkombëtare kreditore, së paku për periudhë prej një viti para se të paraqiten si themelues".

Në paragrafin (3) fjala: “kërkesa” zëvendësohet me fjalët: “kërkesat”, ndërsa fjalët: “parashtron të nënshkruar” zëvendësohen me fjalët: “parashtrojnë të nënshkruara”.

Në paragrafin (4) fjalët: “Në afat prej 30 ditësh nga dita e” zëvendësohen me fjalën: “Pas”.

Në paragrafin (5) shtohet pikë e re a) si vijon:

“a) të kërkojë informatë nga Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit për përfshirjen e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare dhe themeluesit në raste të larjes së parave ose financimit të terrorizmit”.

Pikat a) dhe b) bëhen pika b) dhe v).

#### Neni 31

Në nenin 68 paragrafi (1) pika a) fjalët: “kapital i paguar themelues i përcaktuar” zëvendësohen me fjalët: “kryegjë e paguar themelore e përcaktuar”.

#### Neni 32

Në nenin 71 paragrafi (1) fjalët: “kopje të verifikuara nga aktet themeluese dhe statuti” zëvendësohen me fjalët: “kopje e verifikuar nga statuti”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

“(3) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fond pensional vullnetar Agjencia e regjistron fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe i cakton numër identifikimi.

(4) Regjistrimi i fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare.”

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

#### Neni 33

Në nenin 72 paragrafi (1) fjala: “paraprak” shlyhet dhe fjalia e dytë ndryshohet si vijon: “Për ndryshimet e krijuara jashtë nga kontrolli i shoqërisë, ajo është e obliguar ta njoftojë Agjencinë”.

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

“(2) Agjencia i vlerëson ndryshimet nga paragrafi (1) i këtij neni në pajtim me dispozitat për plotësimin e kushteve nga neni 68 i këtij ligji.

(3) Agjencia e përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni.”

#### Neni 34

Në nenin 76 paragrafi (1) fjalët: “paragrafi (7)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (3)”, ndërsa pas fjalëve: “68 nga ky ligj”, shtohen fjalët: “ose nga Ligji për sigurim pensional me financim kapital vullnetar”.

Në paragrafin (2) fjalët: “dhe parregullsitë” shlyhen.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

“(6) Pas shfuqizimit të lejes për menaxhim me fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar në shoqërinë e cila ka menaxhuar me ato fonde pensionale, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për likuidim të shoqërive nga Ligji për shoqëri tregtare ose dispozitat nga Ligji për falimentim.”

#### Neni 35

Në nenin 79 paragrafi (3) në fjalinë e dytë pas fjalës: “fond” shtohen fjalët: “edhe kërkesat për regjistrim të fondit pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) si vijojnë:

"(7) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fond pensional të obligueshëm dhe vullnetar, Agjencia i regjistron fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe u cakton numër identifikimi.

(8) Regjistrimi i fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare."

Paragrafët (7) dhe (8) bëhen paragrafë (9) dhe (10).

#### Neni 36

Në nenin 84 paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Në paragrafin (4) pika v) pas fjalës: "rrogë" shtohen fjalët: "ose si shumë fikse".

#### Neni 37

Në nenin 94 paragrafi (4) shtohet fjali e dytë si vijon:

"Marrëveshja për anëtarësim mund të ndryshohet me aneks vetëm nëse ndodh përfshirje, ndryshim ose përjashtim i personit fizik-pagues nga marrëveshja."

#### Neni 38

Në nenin 95 paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"Pagesa në fond pensional vullnetar për vete ose për person tjetër fizik, nuk mund të kryejë personi i cili ka realizuar të drejtë pensioni në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, i cili tërheq mjete në pajtim me Ligjin për sigurim pensional me financim kapital vullnetar ose i cili realizon kompensim pensional në pajtim me këtë ligj. Nëse anëtari me llogari individuale vullnetare realizon kompensim në para në pajtim me këtë ligj, siguruesi mund të paguajë kontribute në llogarinë e tij profesionale."

#### Neni 39

Në nenin 98 paragrafi (1) në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe financim të terrorizmit".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital kryen supervizion të llogarive për parandalimin e larjes së parave dhe financim të terrorizmit të shoqërive."

#### Neni 40

Në nenin 107 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Për sigurimin e informimit të drejtë dhe objektiv të publikut, shoqëria e cila menaxhon me fond pensional vullnetar është e obliguar që ta dorëzojë çdo material për marketing me pëlqim të Agjencisë dhe nuk guxon të shpallë ose emitojë material të palejuar për marketing. Nëse përfaqësuesi i shoqërisë jep deklaratë gojore ose intervistë për të cilën paraprakisht nuk ka qenë i njoftuar, shoqëria është e obliguar që deklaratën ose intervistën e dhënë në medien përkatëse ta dorëzojë te Agjencia, në afat prej tre ditësh pas dhënies së deklaratës, përkatësisht intervistës.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Agjencia miraton udhëzime për përmbajtjen e reklamave dhe për materialin tjetër promovues të fondeve pensionale vullnetare dhe shoqërive të cilat menaxhojnë me to."

#### Neni 41

Në nenin 108 paragrafi (1) shlyhet.

#### Neni 42

Në nenin 109 paragrafi (7) fjalët: “ose Ligji për sigurim pensional të obligueshëm me financim kapital” shlyhen.

Në paragrafin (8) shtohet fjali e re si vijon: “Shoqëria për menaxhim me fonde pensionale vullnetare është e obliguar që të parashtojë kërkesë në emër të agjentit për regjistrimin e tij në regjistrin e agjentit, nëse personi i plotëson kushtet dhe të dorëzojë kërkesë për shlyerjen e agjentit nga regjistri i agjentëve, nëse nuk plotëson ndonjë nga kushtet nga neni 77 paragrafi (6) nga Ligji për sigurim pensional të obligueshëm me financim kapital”.

#### Neni 43

Neni 113 ndryshohet si vijon:

“(1) Çdo shoqëri është e obliguar që të ketë prospekt informativ për fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq. Prospekti informativ përmban të dhëna të plota, të sakta dhe objektive për fondin pensional vullnetar dhe shoqërinë e cila udhëheq me atë fond, të cilat janë të nevojshme që anëtari potencial të marrë vendim për anëtarësim në fondin pensional vullnetar, edhe atë:

- a) emrin dhe selinë e shoqërisë dhe fondit me të cilin menaxhon;
- b) emrat e anëtarëve të bordit drejtues dhe të bordit mbikëqyrës të shoqërisë;
- v) emrat dhe adresat e aksionarëve dhe pjesëmarrja e tyre në kryegjënë themelore të shoqërisë;
- g) emrin dhe selinë e rojtarit të pronës dhe të dhëna për ndryshime eventuale të rojtarit të pronës të bëra vitin paraprak dhe shkaqet për ndryshimet e tilla;
- d) të dhëna për revizorin e fondit pensional vullnetar dhe shoqërisë;
- gj) shkaqet themelore të investimit për periudhën nga paragrafi (1) i këtij neni dhe vetëkufizimet gjatë investimit, përveç kufizimeve të përcaktuara në këtë ligj;
- e) përgjegjësi gjatë miratimit të vendimeve investuese;
- zh) kompensime, provizione dhe të gjitha harxhimet tjera të cilat paguhen nga anëtarët e fondit pensional vullnetar;
- z) mënyra e anëtarësimit dhe e kalimit;
- x) mënyra e njoftimit të anëtarëve;
- i) e drejta e kompensimit pensional;
- j) portofolin e fondit pensional vullnetar;
- k) numrin e anëtarëve të fondit pensional vullnetar;
- ll) neto vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar dhe
- l) të dhëna tjera për punën e shoqërisë të cilat mund t’i përcaktojë Agjencia për sigurimin e transparencës.

(2) Prospektin informativ nga paragrafi (1) i këtij neni shoqëria është e obliguar që ta shpallë më së voni deri më 31 mars çdo vit rrjedhës, me gjendje të 31 dhjetorit të vitit paraprak, në ueb faqen e shoqërisë dhe në një nga gazetatat ditore me tirazh më të madh të cilat shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga regjistrimi në fondin pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare, shoqëria është e obliguar që ta shpallë prospektin informativ me të dhënat nga pikat a), b), v), g), d), gj), e), zh), z), x), i) dhe l) nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Shoqëria është e obliguar që t’i dorëzojë, me kërkesë të anëtarit të fondit pensional vullnetar, prospektin informativ dhe statutin e fondit pensional vullnetar me të cilin menaxhon dhe të njëjtat t’ia japë në shikim çdo personi i cili do të paraqitet për anëtarësim në fondin pensional vullnetar me të cilin menaxhon ajo shoqëri.”

#### Neni 44

Në nenin 114 pas paragrafit (6) shtohet paragrafi i ri (7) si vijon:

“(7) Njoftimet nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, pas pajtimit paraprak me shkrim nga anëtari, në vend të formës me shkrim mund të dorëzohen edhe në mënyrë elektronike.”

#### Neni 45

Neni 116 ndryshohet si vijon:

“(1) Shoqëria është e obliguar që Agjencisë t’ia dorëzojë informatat në vijim:

a) raporte financiare tremujore të pareviduara dhe raporte vjetore të pareviduara dhe të reviduara për shoqërinë;

b) raporte themelore financiare tremujore të pareviduara dhe raporte plotësuese dhe raporte financiare tremujore të pareviduara dhe raporte vjetore të pareviduara dhe të reviduara për fondin pensional vullnetar;

v) të dhëna më të hollësishme për marrjen dhe bartjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar me theksimin e çdo mjeti individual, datën dhe çmimin e transaksionit dhe personit juridik i cili e kryen shërbimin me letrat me vlerë;

g) të dhëna për harxhimet për Agjencinë, rojtarin e pronës, transaksionet, marketingun, agjentët dhe harxhimet tjera;

d) të dhëna të aksionarëve të shoqërisë duke përfshirë emra dhe adresa;

gj) emrat e anëtarëve të organeve të menaxhimit dhe punësimit në shoqëri dhe lartësia e kompensimeve për punën e tyre;

zh) informatë për njoftime të dorëzuara deri te anëtarët nga neni 114 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji;

z) të dhëna më të hollësishme për numrin e anëtarëve të fondit pensional vullnetar, numri i anëtarëve të cilët janë të anëtarësuar në fondin pensional vullnetar gjatë vitit; numri i atyre të cilët kanë kaluar në fonde tjera pensionale, numri i anëtarëve të vdekur dhe numri i anëtarëve të cilët kanë realizuar kompensim pensional;

x) raporte nga kontrolli i brendshëm dhe revizione të brendshme dhe

i) të dhëna tjera të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Raporte financiare të pareviduara nga paragrafi (1) pika a) dhe b) të këtij neni dorëzohen në afat prej një muaji pas përfundimit të periudhës me të cilën kanë të bëjnë raportet, ndërsa raportet financiare të reviduara nga paragrafi (1) pika a) dhe b) të këtij neni dorëzohen në afat prej 3 muajsh pas mbarimit të periudhës me të cilën kanë të bëjnë raportet.

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) pika v) të këtij neni dorëzohen për çdo datë të vlerësimit më së voni ditën e ardhshme të punës.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) pikat g) dhe z) të këtij neni dorëzohen një herë në muaj, më së voni deri në ditën e pestë të muajit për muajin paraprak.

(5) Të dhënat nga paragrafi (1) pikat d) dhe gj) të këtij neni dorëzohen një herë në vit, më së voni deri më ditën e 15-të nga mbarimi i vitit afarist.

(6) Të dhënat nga paragrafi (1) pika zh) i këtij neni dorëzohen në afat prej një muaji pas mbarimit të periudhës për të cilën kanë të bëjnë të dhënat.

(7) Raportet nga paragrafi (1) pika x) i këtij neni dorëzohen për çdo tremujor, më së voni deri në ditën e pestë të muajit për muajin paraprak.

(8) Agjencia më afërsisht i përcakton llojin dhe periudhën për të cilën kanë të bëjnë të dhënat, mënyrën dhe formën e paraqitjes së të njëjtave dhe procedurën për dorëzimin e tyre.”

#### Neni 46

Në nenin 117 paragrafi (1) pika v) fjala: “individuale” zëvendësohet me fjalët: “vullnetare individuale ose profesionale”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Kompensimin nga paragrafi (1) pika v) e këtij neni e paguan anëtari i fondit pensional vullnetar gjatë bartjes së mjeteve nga njëra në llogari tjetër individuale bankare kur anëtari kalon në fond tjetër pensional vullnetar, ndërsa e paguan siguruesin gjatë bartjes së mjeteve nga një llogari në llogari tjetër profesionale, kur siguruesi kalon në fond tjetër pensional vullnetar. Shoqëria ose përfaqësuesi i shoqërisë i cili menaxhon me fondin pensional, në të cilën aderon anëtari, nuk guxon ta paguajë këtë kompensim.

Në paragrafin (3) pika v) pas fjalës: “sigurues” shtohen fjalët: “ose për shkak të përjashtimit të pjesëmarrësit nga skema pensionale profesionale”.

#### Neni 47

Në nenin 118 paragrafi (2) fjalët: “kompensimet nga neni 117 paragrafi (1) pikat a) dhe b) të këtij ligji mund të zvogëlohen” zëvendësohen me fjalët: “kompensimi nga neni 117 paragrafi (1) pika a) e këtij ligji mund të zvogëlohet”.

#### Neni 48

Në nenin 119 paragrafi (1) fjalët: “edhe për çdo propozim për zvogëlimin e kompensimeve nga neni 117 paragrafi (1) i këtij ligji, më së paku 30 ditë para vendosjes së tyre” shlyhen.

Në paragrafin (2) pas fjalës: “shpall” shtohen fjalët: “në ueb faqen e shoqërisë”.

#### Neni 49

Në nenin 124 paragrafi (3) dhe nenin 134 paragrafi (1) pika e), fjalët: “pas mendimit paraprak të Komisionit për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë” shlyhen.

#### Neni 50

Në nenin 131 paragrafi (1) pika ll) fjalët: “letra me vlerë” zëvendësohen me fjalën: “instrumente”.

Në pikën l) presja dhe fjalët: “pas mendimit paraprak të Komisionit për Letra me Vlerë” shlyhen.

#### Neni 51

Neni 132 ndryshohet si vijon:

“(1) Mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen në letra me vlerë të të botuesit të njëjtë më së shumti deri më 10% nga vlera nominale e letrës individuale me vlerë e lëshuar nga ai botues, përveç në rast të formularëve dhe letrave tjera me vlerë të lëshuara ose për të cilat garanton Republika e Maqedonisë ose vendi anëtar i UE-së ose OECD-së.

(2) Së paku 5% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të investohen në instrumente, përveç depozitave dhe certifikatës për depozitë, të lëshuara nga subjekti i njëjtë i cili nuk është i themeluar nga shteti dhe është i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë ose në vendin anëtar të UE-së ose të OECD-së, me ç’rast më së shumti deri në 7,5% nga mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen në instrumente, përveç depozita dhe certifikatë për depozitë, të subjekteve të tillë të lidhur ndërmjet veti.

(3) Më së shumti 10% nga mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen në depozita dhe certifikatë për depozitë të një banke e cila ka leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, përveç në depozita dhe certifikatë për depozitë në bankë e cila është ruajtës i pronës së fondit pensional vullnetar ku mund të investohet më së shumti 5% nga mjetet e fondit pensional vullnetar. Më së shumti deri në 7,5% nga mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen në depozita dhe certifikata për depozitë në banka të lidhura ndërmjet veti.

(4) Agjencia mund të përcaktojë kufizime të investimeve të llojeve të veçanta të instrumenteve të ndryshme nga kufizimet e përcaktuara në këtë nen dhe në nenin 133 të këtij ligji, të cilat do të vlejnjë në afatin e përcaktuar nga Agjencia, por jo më të gjatë se pesë vjet. Kufizimet nuk mund të jenë plotësisht ose pjesërisht të pezulluara pa njoftim paraprak me shkrim deri te secila shoqëri e cila menaxhon me fondin pensional vullnetar.”

#### Neni 52

Në nenin 135 paragrafi (4) numri: "180" zëvendësohet me numrin: "540".

#### Neni 53

Në nenin 136 pika v) në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "përveç garancisë për ngarkim me borxh nga neni 141 paragrafi (1) i këtij ligji".

#### Neni 54

Në nenin 149 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"(4) Nëse banka pushon të plotësojë ndonjë nga kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni në periudhën deri sa është mbrojtës i pronës së fondit pensional vullnetar, është e obliguar që menjëherë t'i njoftojë shoqërinë dhe Agjencinë dhe të ndërmarrë aktivitete për harmonizim me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni në periudhë jo më të gjatë se tre muaj nga dita kur ka pushuar të plotësojë ndonjë nga kushtet."

#### Neni 55

Neni 158 ndryshohet si vijon:

"(1) Në kontributet vullnetare të paguara nga ana e siguruesit për të punësuarit dhe anëtarët e tij nuk llogaritet dhe paguhet tatim personal mbi të ardhurat. Shuma e lirit për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 4 rroga bruto mesatare mujore në Republikë, të shpallura për vitin paraprak, për të punësuar ose anëtar.

(2) Anëtari i fondit pensional vullnetar i cili paguan mjete personale në fondin pensional të cilat paraprakisht kanë qenë të tatimuara, ka të drejtë në kthim të tatimit personal mbi fitim të llogaritur në shumën e kontributit të paguar në fondin pensional vullnetar. Shuma në të cilën llogaritet kthimi për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 4 rroga bruto mesatare mujore në Republikën, të shpallura për vitin paraprak.

(3) Anëtari i fondit pensional vullnetar për mjetet e paguara në llogarinë e tij individuale nga personi fizik, të cilat paraprakisht kanë qenë të tatimuara, ka të drejtë në kthim të tatimit personal mbi fitim të llogaritur në shumën e kontributit të paguar në fondin pensional vullnetar. Shuma në të cilën llogaritet kthimi për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 4 rroga bruto mesatare mujore të paguara në Republikë, të shpallura për vitin paraprak.

(4) Kthimi i tatimit personal mbi fitim anëtarëve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni kryhet në nivel vjetor drejtpërdrejt në llogarinë individuale vullnetare të anëtarit të fondit pensional, me dorëzimin e kërkesës për kthim të tatimit nga ana e anëtarit ose personit fizik në llogari të anëtarit.

(5) Ministri i Financave më afërsisht i përcakton mënyrën e kryerjes së kthimit të tatimit në llogarinë individuale të anëtarit të fondit pensional vullnetar, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni."

#### Neni 56

Në nenin 164 paragrafi (1) pas numrit: "167" shtohet numri: "167-a" dhe vihet presje.

#### Neni 57

Në nenin 165 paragrafi (1) fjalët: "deri në 50.000" shlyhen.

Në pikën 2 fjalët: "e paguan kapitalin" zëvendësohen me fjalët: "e paguan kryegjënë themelore".

Në pikën 3 fjalët: "kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "kryegjëja themelore".

Pika 15 ndryshohet si vijon: "investon mjete nga fondi pensional vullnetar në kundërshtim me instrumentet dhe kufizimet e parapara në nenet: 131, 132, 133 dhe 134 të këtij ligji;"

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumën nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare, nëse:

- 1) kryen veprimtari të cilat nuk janë të parapara në nenin 16 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 2) nuk e zmadhon dhe mban kryegjënë në pajtim me nenin 19 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji;
- 3) nuk i mban dhe nuk i zmadhon mjetet personale të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia në pajtim me nenin 19 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji;
- 4) nuk mban mjete likuide në pajtim me nenin 19 paragrafi (9) të këtij ligji;
- 5) bën bashkëngjitje në kundërshtim me nenet 47, 48 dhe 51 të këtij ligji;
- 6) bën ndryshime pa leje të Agjencisë në pajtim me nenin 44 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 7) menaxhon me fondet pensionale të obligueshme pa leje nga Agjencia nga neni 67 paragrafi (1) i këtij ligji dhe
- 8) parashton kërkesë për leje për pëlqim për ushtrim të veprimtarisë – menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe në dokumentacionin e parashtruar dorëzon të dhëna të pasakta në kundërshtim me nenin 67 paragrafi (2) i këtij ligji."

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumën nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nëse:

- 1) kryen veprimtari të cilat nuk janë të parapara në nenin 16 paragrafi (2) të këtij ligji;
  - 2) nuk e zmadhon dhe mban kryegjënë në pajtim me nenin 20 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji;
  - 3) nuk i mban dhe nuk i zmadhon mjetet personale të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia në pajtim me nenin 20 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji;
  - 4) nuk mban mjete likuide në pajtim me nenin 20 paragrafi (9) të këtij ligji;
  - 5) blen aksione në shoqëri tjetër për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare ose riorganizohet, në kundërshtim me nenin 27 paragrafi (5) i këtij ligji;
  - 6) bën ndryshime pa leje nga Agjencia në pajtim me nenin 60 paragrafi (1) i këtij ligji;
  - 7) bën ndryshime pa leje nga Agjencia në pajtim me nenin 66 të këtij ligji;
  - 8) bën ndryshime pa leje nga Agjencia në pajtim me nenin 72 të këtij ligji dhe
  - 9) bën bashkëngjitje në kundërshtim me nenet 78, 79 dhe 82 të këtij ligji;
- Në paragrafin (9) fjalët: "deri në 5.000" shlyhen.

#### Neni 58

Në nenin 166 paragrafi (1) fjalët: "deri në 30.000" shlyhen.

Në pikën 2 pas numrit: "33" shtohen fjalët: "paragrafi (2)".

Pika 7 ndryshohet si vijon:

"jep informata të gabuara dhe të pasakta për fondin pensional vullnetar, për skemën pensionale profesionale ose për shoqërinë e cila menaxhon me atë fond sipas nenit 107 paragrafi (1) të këtij ligji."

Në pikën 10) pas numrit: "116" shtohen fjalët: "paragrafi (1)".

Pika 13) ndryshohet si vijon:

"vepron në kundërshtim me kufizimet e parapara me nenin 135 të këtij ligji;"

Në paragrafin (2) fjalët: "për menaxhim me fonde pensionale" shlyhen.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe personit përgjegjës në shoqërinë."

Në paragrafin (4) fjalët: "për menaxhim me fonde pensionale" shlyhen.

#### Neni 59

Në nenin 167 paragrafi (1) fjalët: “deri në 10.000” shlyhen.

Pika 3) ndryshohet si vijon:

“jep deklarata ose parashikime për rezultatet e ardhshme investuese për fondin pensional vullnetar sipas nenit 107 paragrafi (2) të këtij ligji”.

Në pikën 5) fjalët: "(3) dhe (4)" zëvendësohen me fjalët: "dhe (3)".

Pika 6) ndryshohet si vijon:

“nuk dorëzon propekt informativ dhe statut të anëtarit të fondit pensional vullnetar, nuk ua jep për shikim personave në pajtim me nenin 113 paragrafi (4) të këtij ligji”.

Në paragrafin (2) fjalët: "për menaxhim me fonde pensionale" shlyhen.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe personit përgjegjës në shoqërinë”.

Në paragrafin (4) fjalët: "për menaxhim me fonde pensionale" shlyhen.

Në paragrafin (3) fjalët: “deri në 2.000” shlyhen.

#### Neni 60

Pas nenit 167 shtohet nen i ri 167-a si vijon:

##### “167-a

“(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nëse: 1) nuk vepron për ndonjë nga kërkesat nga neni 28 paragrafi (3) i këtij ligji;

2) nuk përpilon plan vjetor për punë, raport për punën e tij dhe nuk i dorëzon te Agjencia në pajtim me nenin 34 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji;

3) nuk dorëzon për pëlqim te Agjencia ose publikon material të palejuar për marketing, nuk e njofton Agjencinë për deklaratën gojore ose intervistën në afatin e përcaktuar, në pajtim me nenin 107 paragrafi (4) të këtij ligji;

4) nuk dorëzon të dhëna dhe informata te Agjencia në afatet e parapara me nenin 116 paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij ligji.

5) menjëherë nuk e njofton Agjencinë për vlerën e mjeteve neto të fondit pensional vullnetar dhe vlerën e njësisë kontabiliste të fondit pensional vullnetar në pajtim me nenin 126 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare, nëse:

-nuk vepron në pajtim me nenin 109 paragrafi (8) të këtij ligji.”

#### Neni 61

Në nenin 168 paragrafi (1) fjalët: “deri në 50.000” shlyhen.

Në paragrafin (1) shtohet pikë e re 1 si vijon:

“1) nuk i mënjanon parregullsitë në pajtim me nenin 53 paragrafi (6) nga Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Pika 1) bëhet pikë 1-a.

Në paragrafin (3) fjalët: “deri në 5.000” shlyhen.

#### Neni 62

Në nenin 169 paragrafi (1) fjalët: “deri në 1.500” shlyhen.

Neni 63

Në nenin 170 paragrafi (1) numri: "500" zëvendësohet me numrin: "1.000".  
Pika 1) shlyhet.

Neni 64

Në nenin 171 paragrafi (1) fjalët: "deri në 7.000" shlyhen.  
Në paragrafin (3) fjalët: "deri në 2.000" shlyhen.

Neni 65

Në nenin 172 paragrafi (1) fjalët: "deri në 30.000" shlyhen.  
Në paragrafin (2) fjalët: "deri në 3.000" shlyhen.

Neni 66

Agjencia i regjistron fondet ekzistuese pensionale vullnetare në regjistrin e fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe u cakton numër identifikimi në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 67

Shoqëritë ekzistuese për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare janë të obliguara që të harmonizohen me dispozitat të cilat kanë të bëjnë me nenin 28 paragrafët (7) dhe (8) të Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 7/2008), në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 68

Dispozita e cila ka të bëjë me nenin 95 paragrafi (6) të Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/2008), nuk do të zbatohet për personat fizikë të cilët kanë paguar kontribut në llogari individuale vullnetare të anëtarit të fondit pensional vullnetar në bazë të marrëveshje për anëtarësim, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 69

Shuma e lirit nga tatimi personal mbi të ardhura të kontributeve vullnetare të paguara nga ana e siguruesit për të punësuarit dhe anëtarët e tij, për vitin 2009 dhe 2010 nuk mund të jetë më e madhe se gjashtë rroga neto mujore mesatare në Republikë, të shpallura për vitin paraprak për të punësuar ose anëtar.

Shuma në të cilën llogaritet kthimi i tatimit personal mbi fitim i anëtarit të fondit pensional vullnetar i cili paguan mjete personale në fondin pensional vullnetar për vitet 2009 dhe 2010 nuk mund të jetë më e madhe se gjashtë rroga neto mujore mesatare në Republikë, të shpallura për vitin paraprak.

Shuma në të cilën llogaritet kthimi, i tatimit personal mbi fitim i anëtarit të fondit pensional vullnetar për mjetet e paguara në llogarinë e tij individuale nga personi fizik, për vitin 2009 dhe 2010 nuk mund të jetë më e madhe se gjashtë rroga neto mujore mesatare në Republikë, të shpallura për vitin paraprak.

Neni 70

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 71

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".